REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 123/17
Datë/Datum 05.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Universiteti i Prishtinës".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **123/17**, parashtruar nga OE ***,"Europrinty"*****shpk** – Prishtinë.		
Datë:	**05.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "*"Furnizim me tonera për nevojat e universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të Prokurimit: 2242/17/45/111.* të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Universiteti i Prishtines"**, dhe me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"Europrinty" sh.p.k-Prishtinë,** me nr. **123/17,** të datës **21.04.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Universiteti i Prishtinës".**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - **"Europrinty"shpk** – Prishtinë

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		26.04.2017		**02.05.2017**		**05.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **21.04.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **123/17,** e parashtruar nga OE **„Europrinty"shpk, - Prishtinë**, kundër AK – *Universiteti i Prishtinës*, lidhur me aktivitetin e prokurimit: *"Furnizim me tonera për nevojat e universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të Prokurimit: 2242/17/45/111.*
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – Universiteti i Prishtinës.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , Europrinty,shpk , me seli në Prishtine.

Pikat e Ankesës nga OE **„Europrinty"shpk, - Prishtinë**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:* Neni 7, 54 dhe 60.

Ne si OE të eleminuar nga ky aktivitet i prokurimit konsiderojmë se kemi qenë te pergjegjeshem , pasi qe nuk kemi bere asnje shkelje ligjore te ligjit te prokurimit ne fuqi dhe se ne mendojme qe AK ne kete rast eshte ai qe ka bere shkelje ligjore te ligjit konkretisht nenit me nr. 7, 54 dhe 60, paragrafi

1. Ne nuk jemi njoftuar me shkrim permes (me email) permes shkreses zyrtare apo letres standarde per tenderuesin e pasukseseshem as permes e-prokurimit.

Ne ne qarkullim per tri (3) vitet e fundit kemi pasur shumen mbi gjashqin mi euro (600.000€) ku kete e kemi deshmuar me kontrata dhe fatura te pranuara te gjitha kane qene te nenshkruara dhe vulosura te vitit 2014 – 2015 – 2016, te bashkangjitura ne D.T.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Siq e potencuam edhe me lart AK ka bere shkelje te ligjit (LPP-se) perkatesisht nenit 7, 7.1, nenit 60, 60.1 dhe 69. Ku do e citojm nenin ne vijim

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pastaj ka pas shkelje te nenit 60, 60.1

Ne si OE pjesemarres kemi qene edhe kompani e pergjegjeshme dhe kemi ofruar me cmim me te ulet se OE I shperblyer me kontrate, me qerast AK ka bere shkelje te nenit 60. 60.1. Ne jemi eleminuar vetem se nuk kemi cekur afatin e liferimit edhe pse nuk eshte kerkuar ne FDT *Demet material:* Kostoja per shpenzimet bankare te ankeses, pergaditja e ankeses dhe fitimi eventual I humbur.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : ..... 30.01.2017 *Lloji i procedurës së aplikuar:*..... Procedurë e hapur *Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:* .....furnizim/vlerë e madhe *Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):* .....10.03.2017 *Data e hapjes së ofertave* .....10.03.2017 *Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :*.....11.04.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1 Kerkesat e pershtatshmerise **Kërkesa 1**: Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. **Kërkesa 2**: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. **Kërkesa 3**: Vërtetimin nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit.	**Deshmia Dokumentare** **Evidenca 1**: Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik **Evidenca 2**: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal **Evidenca 3**: Vërtetimin nga Gjykata themelore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratësorigjinal
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa 1**. Certifikata e regjistrimit të biznesit **Kërkesa 2.** Certifikata e regjistrimit të TVSH-së **Kërkesa 3**. Certifikata e regjistrimit të numrit fiscal	**Deshmia Dokumentare** **Evidenca 1**. Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit **Evidenca 2**. Kopja e Certifikatës e TVSH-së **Evidenca 3**. Kopja e Certifikatës me numër fiskal (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj se ne tri vitet e fundit 2014,2015,2016, ka pasur qarkullim me kontrata(Te përfunduara 2014,2015,2016) per furnizim me Tonera 600,000.00€,	**Deshmia Dokumentare** 1.Kopjet e kontratave . **Deshmia Dokumentare.** 1. Dëshmia e kontratave me referenca me se paku tre.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Operatori Ekonomik (OE) duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses ,3 kontrata në fushen e njejtë, të përcjellë me referenca në 3 (tri) vitet e fundit (2014, 2015, 2016). 2. Te gjitha paisjet duhet të jenë Brand name,kualitative. 3. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit 4. Deklaratë për Tonerat se janë origjinal 5. Deklaratë për specifikimin teknik të paisjeve 6. Auorizimin nga prodhuesi (MAF = Manufacturer Authorization Form) ose Distributori i autorizuar,origjinal ose kopje e noterizuar	OE duhet të ofroj së paku 3 projekte per furnizim të Tonerave , për tre vitet e fundit 2014,2015,2016, duke ju bashkangjitur referencat përkatëse. 2. Cerftifikata e kualitetit 3. OE duhet të ofroj një deklaratë për caktimin e menaxherit të projektit, të bashkangjitur CV 4. OE duhet të ofrojë një deklaratë qe dëshmon se tonerat janë origjinal.(Origjinal) 5. OE duhet të ofrojë një deklaratë me të cilën siguron që paisjet që ofron i përshtatet specifikimit teknik të kërkuar në Aneks 1 të dosjes së tenderit. B05 Njoftim per Kontrat 6. Autorizimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar (Origjinal ose i noterizuar) për keto lloje: HP,Samsung ,Dell,Canon,Kyocera (minimum per 4 lloje te sillen autorizimet)

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	NTP "Office - Printy"	Prishtinë	174,995.27 €	JO
2.	"Europrinty"shpk	Fushë Kosovë	136,143.20 €	JO
3.	NT "Info Com"	Mitrovicë	386,986.00 €	JO
4.	NTG "Blendi"	Prishtinë	161,990.00 €	JO
5.	"Infosoft Ofice"shpk	Prishtinë	380,049.01 €	JO
6.	NTSH "Rikon"	Prishtinë	380,246.21 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 10.03.2017, *në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katërmbëdhjetëgjashtë (6) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Hajrulla Hajrullahu
- - Anëtar i komisionit - Shaban U...
- - Anëtar i komisionit – Blerande Dragusha

Data e mbarimit të vlerësimit: 03.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....03.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

OE i rekomanduar per kontrate NTSH "RIKON" .

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës të përfshira në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1 Autoriteti Kontraktues / Universiteti i Prishtinës, gjatë këtijë aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike (kornizë – 36 muaj) me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: **"Europrinty"shpk,** ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënje të kontratës, gjegjësisht kundër arsyetimit të eleminimit sipas përshkrimit në ankesë. (Letra standarde nuk ekziston në shkresa të lëndës, kundrejt ofertes së OE ankues).

- Kundër njoftimit për dhënje, OE "Europrint"shpk, më datën 13.04.2017, paraqet kërkesë për rishqyrtim pranë AK – UP, me pretendimet ankimore se AK, me rastin e njoftimit për dhënje të kontratës, gjegjesisht me eleminimin e OE "Europrinty"shp, ka bërë shkelje të nenint 7, 54, dhe 60, të LPP-së. Kundrejt të njejtës kërkesë AK – UP, nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar, ndërsa lë në fuqi njoftimin për dhënje të kontratës.

Sqarimi 2 Pretendimi kryesor ankimor sipas përshkrimit në ankesë, ka të bëjë me kërkesën e paraparë në pikën 8.1 & 8.2, të FDT-së, "kapaciteti ekonomik dhe financiar", ku AK–UP, tekstualisht ka kërkuar: "*Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se në tri vitet e fundit 2014, 2015, 2016, ka pasur qarkullim me kontrata (të përfunduara 2014,2015,2016) për furnizim me tonera 600,000.00€*". Për të njejtën kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: "***Kopjet e kontratave***".

- Kundrejt kërkesës së lartëpërmendur (8.1 & 8.2, të FDT-së), OE ankues "Europrinty"shpk, në shkresa të lëndës posedon listen sipas përshkrimit me gjithësej trembëdhjetë (13) pozicione, me vlerë totale të përshkruar prej, 306 296.90 €, si dhe fatura të ndryshme me anë të cilave e mbulon **vleren** e kërkuar të kërkesës, por jo edhe dëshminë dokumentare / kopjet e kontratave. Megjithatë vleresimi ynë është që kërkesa e AK-së, konkretisht dëshmia dokumentare nuk është në harmoni me dispozitat e nenit **68,** të LPP-së në fuqi, pasi që për dëshmi të gjendjes ekonomike dhe financiare, nuk parashifen "kopjet e kontratave", për më tepër paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 15, i nenit 68, të LPP-se, parashef si më poshtë:

1.1.raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;

1.2.evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;

1.3.kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

1.4.kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

1.5.*Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. Për më tepër kërkesën e njejtë, të modifikuar por pa precizuar vlerën, AK-UP, e ka aplikuar edhe tek kërkesa 9.1 & 9.2, e FDT-se "Kapaciteti teknik dhe profesional".*

Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankesë pretendon edhe për shkelje të nenit 54, të LPP-së, gjegjësisht potencon se nuk është njoftuar me letër standarde mbi arsyet e leminimimit. Për të njeten situtë sqarojme se AK- UP, për këtë aktivite të prokurimit e ka aplikuar formën elektronike e-prokurimi, ku edhe parashtruesi i ankesës ka ofertuar në të njejtën mënyrë, ndërsa OSHP, ende nuk ka qasje në prokurimet elekronike të autoriteteve kontraktues, konkretisht shqytimin – trajtimin e

pretendimeve ankimore e bejme përmes shkresave fizike, rrjedhimisht nuk mundë të vërtetojmë pretendimin ankimore për respektim apo mos respektim të nenit 54, të LPP-së.

Poashtu parashtruesi i ankeses përmes deklarates në ankes thekson si arsyetim të eleminimit edhe afatin e liferimit pëkundër asaj që nuk është kërkuar, megjithatë në munges të letrës standarde, i jemi referuar vendimit të AK-së, kundrejt kërkesës për ri shqyrtim, dhe se si arsye e pa përgjegjëshmërisë së OE ankues "Europrinty"shpk, nuk përmendet afati i liferimit.

Përfundimisht në mbështetje të sqarimeve të potencuara më lartë, propozimi ynë për AK- UP, është që ky aktivitet i prokurimit, <u>të anulohet</u> pasi që kërkesa e përcaktuar në pikën **8.1 & 8.2**, të FDT-së, "kapaciteti ekonomik dhe financiar", gjegjësisht dëshmia dokumentare (**8.2**) "kopjet e kontratave", nuk parashifet në ndonjerërën nga dispozitat e neni 68, të LPP-së, në fuqi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shyqerues që aktiviteti i prokurimit me titull: "Furnizim me tonera për nevojat e universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. të Prokurimit: **2242/17/45/111,** të **ANULOHET,** dhe nëse ende AK, shpreh interes për të, ta Ri-tenderoj.
- Gjithashtu eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të aprovoi ankesen e operatorit ekonomik "Europrinty"shpk, si **të bazuar pjesërisht.**